




Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna Rahovec/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Drejtoria Komunale e Arsimit
Odeljenje za Obrazovanje
Department of Education

Në bazë nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 84 dhe 85 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, neni 5, neni 14 paragrafi 1 pika 1.1 dhe neni 15 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr.1427 të datë 28.04.2017, Drejtoria për Arsim në Komunën



Konkurs

Nr. I prot. 212 Më 29.04.2022
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

(Thirrje e dytë për aplikim)

Për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2021/2022

1. Bursat ndahen për vitin akademik 2021/2022 për shkollimin universitar.
2. Numri i bursave të planifikuara është 40 (katërdhjetë) bursa ;
3. Lartësia e bursës është 50 Euro (pesëdhjetë euro) për muaj, për gjithësej 9 muaj;
4. Lartësia e bursës është 60 euro për studentë që kanë notën mesatare mbi 9, për gjithësej 9 muaj.

Kriteret për ndarjen e Bursave:

Për ndarjen e bursave do të aplikohen këto kriteret:

- Lëmia e studimit;
- Suksesi gjatë studimeve (Nota Mesatare);
- Gjendja ekonomike familjare;
- Fëmijë të të rënëve në luftë.

Kohëzgjatja e akordimit (dhënies së bursës):

- Bursa akordohet me kohëzgjatje prej 1 (një) viti me të drejtë vazhdimi, nëse përfituesi i bursës ka regjistruar me sukses vitin pasues .

Dokumentet e nevojshme për aplikim për bursë:

- Kërkesa me biografi të shkurtër ;
- Vërtetimi me të cilin vërtetohet lëmia e studimit (Fakulteti i cili regjistrohet) ;
- Çertifikata e notave;
- Fotokopja e indexit ose ID- kartelës ;
- Dëshmia mbi gjendjen sociale;
- Vërtetimin me të cilin vërtetohet përkatësia e familjes së të rënit në luftë;
- Kopjen e letënjoftimit.

Të drejtë aplikimi kanë vetëm studentët e regjistruar në Universitetet Publike.

Kohëzgjatja e konkursit:

- Afati i konkurimit është 10 ditë kalendarike nga dita e publikimit të konkursit në mjetet e informimit publik;
- Dokumentet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen;
- Dokumentet dorëzohen në zyrat e Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit.
- Afati i fundit për aplikim është data 10.05.2022 deri në ora 16:00.

Arsyetim:

Thirrja e dytë për aplikim bëhet për arsye se kemi numër të madh të aplikuesve për përfitimin e bursës komunale për studentë, për shkak se një numër i studentëve të vitit të parë nuk kanë arritur t'i dorëzojnë certifikatat e notave të provimeve të dhëna në periudhën sa zgjati afati i aplikimit në thirrjen e parë.

Për këto arsye, Komuna e Rahovecit dhe Drejtoria Komunale për Arsim, ka vendosur që të rrisë numrin e përfituesve edhe për 40 studentë, në përputhje me mundësitë buxhetore të saj.

**Rahovec,
29.04.2022**



Avni Morina

Avni Morina
Drejtor